

AKT THEMELIMI DHE STATUT I "SHËRBIME SIGURIE SIAR SHPK"

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"SHËRBIME SIGURIE SIAR" SHPK

Marin Hoxhaj

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'Marin Hoxhaj', written over a horizontal line. The signature is stylized and cursive.

AKT THEMELIMI DHE STATUT "SHËRBIME SIGURIE SIAR"

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQERISE ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR "SHËRBIME SIGURIE
SIAR" SHPK

KREU I

EMRI I SHOQERISE, SELIA, KOHEZGJATJ A. OBJEKTI

NENI 1

EMRI I SHOQERISE

- 1.1 Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "SHËRBIME SIGURIE SIAR" SHPK (më poshtë e quajtur "Shoqëria").

NENI 2

S E L I A

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rr. Pasho Hysa nr. 45/1. Tiranë
2.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosi mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Organi administrues i Shoqërisë mund të themelojë ose mbyll degë dhe ose zyra përfaqësimi, brënda apo jashtë Republikës së Shqipërisë.

NENI 3

KOHËZGJATJA

- 3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore me afat të pacaktuar

NENI 4

OBJEKTI I SHOQERISE

- 4.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në baze të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke u fokusuar kryesisht:

Import, eksport, tregtim me shumicë dhe pakicë të pajisjeve elektronike, elektrike, sistemeve të sigurisë, pajisjeve kompjuterike si: kompjutera, laptop, kamera dixhitale, server, projektorë, skaner, printera, fotokopje, fakse, kamera sigurie, kamera për mbikqyrje, kamera amatore, alarme sigurie, sisteme kundërzjarrit, pajisje të fikjes së zjarrit, radiokomunikimit, sisteme kontrolli hyrje-dalje, sisteme televizive, pajisje të navigacionit, sisteme GPS/GPRS, sisteme të nderlidhjes, mikrofonave të transmetimit të zërave valor ose digjital, sisteme të kontrollit dhe monitorimit në distance të automjeteve, sisteme video-citofonie, sisteme telefonike PBX, sisteme të menaxhimit të parkimit, sisteme kompjuterike etj.

Sigurimi i pjeseve të këmbimit për të gjitha llojet e pajisjeve dhe realizimi i mirëmbajtjes, garancisë e riparimit. Realizimi i projektimit, instalimit dhe certifikimit të rrjeteve kompjuterike, informatike dhe mirëmbajtjen e tyre. Realizimi i kontroleve periodike për rritjen e sigurisë dhe parandalimin e rrjedhjes së informacioneve vetjake apo industriale, instalimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve që parandalojnë rrjedhjen e këtyre informacioneve. Mbledhje dhe grumbullim informacioni, verifikime dhe kryerje veprimesh operative konform vendimit të gjykates nr. 5180/2015.



AKT THEMELIMI DHE STATUT "SHËRBIME SIGURIE SIAR"

Programim programe, implementim i sistemeve dhe programeve informatike (softëare-ve), mirëmbajtje sistemeve dhe programeve informatike, asistence dhe konsulencë për përgatitjen e programeve informatike (softëare-ve).

Shërbimin e transmetimit të të dhënave, kodifikimin, kriptimin dhe transferimin fizik nëse lind nevoja.

- 4.2 Për përmbushjen e objektit të saj Shoqëria:
Mund të marr pjesë dhe të jetë e interesuar në shoqëri dhe sipërmarrje, shqiptare apo të huaja, që kryejnë aktivitete të njëjta, të ngjashme apo të lidhura me aktivitetin e saj ose të subjekteve pjesëmarrëse;
- 4.3 Shoqëria mund të veprojë në Shqipëri dhe jashtë saj dhe të kryej çdo aktivitet tjetër të lidhur ndihmës me qëllim të përmbushës ose të jetë i dobishëm për përmbushjen e objektit të saj.

KREU II

KAPITALI, KALIMI I KUOTAVE, ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

NENI 5

KAPITALI I SHOQERISE

- 5.1 Kapitali i Shoqërisë është 100.000 (Njëqindmijë) Lekë. i dëbuar në një kuotë të vetme. Kapitali i Shoqërisë nënshkruhet menjëherë dhe do të paguhet nga administratori në 100% (njëqind për qind) të kontributit në kapitalin e shoqërisë, përkatësisht:
- Z. Marin HOXHAI, shtetas shqiptar, i lindur në Tiranë, më 24.06. 1982, i identifikuar me nr personal **I20624063H**, i cili zotëron 100% (njëqind për qind) të kapitalit:

5.2 Në rast zmadhimi apo zvogelimi të kapitalit themeltar të Shoqërisë, administratori do të ketë të drejtën e nënshkrimit të zmadhimit apo zvogelimit të kapitalit.

NENI 6

KALIMI I KUOTAVE ME TRASHËGMI OSE SI PASOJË E FALIMENTIMIT

- 6.1 Në rast se administratori humb jetën, trashëgimtarët e tij do të jenë të vetmët persona që do të njihet titulli mbi Shoqërinë; por asnjë nga këto parashikime nuk çliron përgjegjësitë e trashëgimtarëve nga çdo detyrim i mbartur nga kuota e zotëruar.
- 6.2 Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e humbjes së jetës ose falimentimit të administratorit mund të zgjedh të bëhet zotëruar i kuotës ose të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër të caktuar prej tij si përfitues i kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotëruar i kuotës, ai njofton Shoqërinë në lidhje me këtë zgjedhje. Nëse personi i mësipërm zgjedh të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër atëherë ai duhet ta kryej atë nëpërmjet një akti të vlefshëm të transferimit të kuotës.
- 6.3 Personi që fiton të drejtat mbi një kuotë si pasojë e humbjes së jetës ose falimentimit të administratorit do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruar i Shoqërisë, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit në regjistrin tregtar si zotëruar i kuotës.



AKT THEMELIMI DHE STATUT "SHËRBIME SIGURIE SIAR"

**NENI 7
ZMADHIMI I KAPITALIT**

7.1 Asambleja e Përgjithshme mund të zmadhojë kapitalin e Shoqërisë, me kuotimin e përcaktuar në nenin 9.11 të këtij Akt Themelimi dhe Statuti. Vendimi i Asamblese së Përgjithshme për zmadhimin e kapitalit do të komunikohet me shkrim administratorit që është thirrur por nuk ishte i pranishëm në mbledhjen e Asamblese së Përgjithshme që vendosi për zmadhimin e kapitalit.

7.2 Në rast zmadhimi të kapitalit, administratori do të ketë të drejtën të nënshkruajë në zmadhimin e kapitalit, në para ose me kontribute në natyrë. Në rast se disa ortakë heqin dorë nga e drejta e nënshkrimit të pjesës së tyre, kapitali i panënshkruar mund të nënshkruhet nga ortakët e tjerë.

**NENI 8
ZVOGELIMI I KAPITALIT**

8.1 Asambleja e Përgjithshme mund të zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë, me kuotimin e përcaktuar në nenin 9.11 të këtij Akti Themelimi dhe Statuti. Në çdo rast, kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën kufirin e përcaktuar me ligj.

**KREU III
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

**NENI 9
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**


9.1 Asambleja e Përgjithshme është organi vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vendos mbi të gjitha çështjet për të cilat është kompetente sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë, sipas këtij Akti Themelimi dhe Statuti dhe/ose çdo marrëveshje midis ortakëve të Shoqërisë.

9.2 Administratori ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, të shprehë vullnetin e saj si dhe të votojë në përputhje me kapitalin që ajo zotëron në Shoqëri.

9.3 Administratori mund të përfaqësohet nga një përfaqësues i deleguar me prokurë me shkrim.

9.4 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblese së Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën audio ose video, në përputhje me legjislacionin për shoqëritë tregtare dhe komunikimet elektronike.

9.5 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga Administratori i Shoqërisë. Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim ose inc mjete elektronike, dërguar secilit prej ortakëve në adresat e njoftuara Shoqërisë, të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes.



AKT THEMELIMI DHE STATUT "SHËRBIME SIGURIE SIAR"


- 9.6 Asambleja e Përgjithshme do të mbledhet rregullisht, pavarësisht nga këto formalitete, në rast se të gjithë ortakët apo përfaqesuesit e tyre janë të pranishëm dhe bien dakord për rendin e ditës.
- 9.7 Mbledhjet e Asamblese së Përgjithshme kryesohen nga Administratori/et.
Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për çdo mbledhje midis personave të pranishëm.
- 9.8 Vendimet e Asamblese së Përgjithshme duhet të jenë me shkrim dhe të firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kërkesë të ortakëve, vendimet duhet të përfshijnë dhe deklaratat apo vërejtjet e tyre.
- 9.9 Asambleja e Përgjithshme mbledhet të paktën njëherë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.
- 9.10 Asambleja e Përgjithshme, në rastin e vendimeve që kërkojnë shurnicen e zakonshme, merr vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote ose përfaqësuesit e tyre, që zotërojnë më shumë se 30%(tridhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë, përveç rasteve të parashikuara.
Më poshtë në nenin 9.11 në rast se kjo kuotë nuk arrihet, Asambleja e Përgjithshme thirret në një mbledhje të dytë brenda 30 (tridhjetë) ditëve.
- 9.11 Asambleja e Përgjithshme vendos me votat pro të ortakeve pjesëmarrës apo të përfaqësuar që zotërojnë me shumë se 50% të kapitalit të Shoqërisë për ndryshimin e këtij Akt Themelimi dhe Statutit, zmadhimit ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

ADMINISTRATORI I SHOQERISE

NENI 10

ADMINISTRATORI I SHOQERISE

- 10.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë Administratorë të cilët zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh. Administratori mund të rizgjidhet dhe shkarkohet në çdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme.
- 10.2 Administratori zotëron kompetenca të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryej të gjitha aktet që konsideron të nevojshine për realizimin e objektivit të Shoqërisë, përveç atyre që ligji apo ky Akt Themelimi dhe Statut ia rezervon Asamblesë së Përgjithshme apo organeve të tjera të Shoqërisë.
- 10.3 Administratori vepron në përputhje me politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera në administrimin e Shoqërisë. Administratori mund të delegoj persona të tretë për kryerjen e veprimeve dhe akteve që kanë të bëjnë me administrimin e Shoqërisë, duke mbajtur përgjegjësit për të gjitha veprimet e kryera nga të tretët e deleguar për administrimin e Shoqërisë.
- 10.4 Administratori do të veproj në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të Shoqërisë, Në rast konflikti interesi, administratori do të njoftoj menjëherë ortakët si dhe dorëheqjen nga çdo veprim që lidhet me objektin e konfliktit të interesit deri në marrjen e udhëzimeve nga Asambleja e Përgjithshme.
- 10.5 Administratori i pare i Shoqerise do te jete:
Z. Marin HOXHAI, shtetas shqiptar, i lindur në Tiranë më 24.06. 11982, identifikuar me nr personal **I20624063H'**



AKT THEMELIMI DHE STATUT "SHËRBIME SIGURIE SIAR"

NENI 11
SHPERBLIMI I ADMINISTRATORIT

11.1 Asambleja e Përgjithshme përakton shpërblimin e Administratorit të Shoqërisë

NENI 12
PËRFUNDIMI I DETYRËS SË ADMINISTRATORIT

12.1 DETYRA E Administratorit përfundon në rast se:

- a) i përfundon mandati;
- b) shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme;
- c) jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar Shoqërinë;
- d) personi nuk gëzon cilësinë e administratorit sipas parshikimeve ligjore;
- e) mungon pa arsye në detyrë më shumë se 6(gjashtë) muaj radhazi, dhe Asambleja e Përgjithshme vendos ta shkarkojë nga detyra.

KREU V
KONTROLI FINANCIAR I SHOQËRISË,
VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, DIVIDENTI

NENI 13
KONTROLI FINANCIAR

13.1 Kontrolli financiar i shoqërisë kryehet në përputhje dhe sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Asambleja Kombëtare do të emërojë një ose më shumë ekspert Kontabël të Autorizuar në ato raste kur është i nevojshëm apo i parashikuar nga ligji.


NENI 14
VITI FINANCIAR

14.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të çdo viti.

NENI 15
BILANCI VJETOR

15.1 Bilanci Vjetor, pasqyrat financiare, inventari, raportet e Administratorit dhe të Ekspertit Kontabël të Autorizuar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori i paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme raportin mbi administrimin e Shoqërisë si edhe llogaritë vjetore.

15.2 Dokumentet që kanë të bëjnë me vitin financiar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme brenda 6(gjashtë) muajsh nga mbyllja e vitit financiar.



AKT THEMELIMI DHE STATUT "SHËRBIME SIGURIE SIAR"

NENI 16
DIVIDENTI

16.1 Pasi të jenë përmbushur kërkesat e përcaktuara nga ligji për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, Shoqëria, Me shumicë të votyave të Asamblesë së Përgjithshme mund të vendosë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

16.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtata që i bashkangjiten kuotave, të gjithë dividendët duhen të deklarohen dhe paguhet sipas shumave të paguara në kuotat në të cilat paguhet dividendi

KREU VI
PRISHJA DHE LIKUIDIMI, LIGJI I ZBATUESHEM,
ZGJIDHJA E MOSPARREVESHJEVE

NENI 17
PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

17.1 Në rastin e prishjes dhe likuidimit të Shoqërisë do të zbatohen dispozitat e parashikuara në ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.

NENI 18
LIGJI I ZBATUESHEM

18.1 Shoqëria do zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Akt Themelimi e Statut, edhe ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë akt, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare.


NENI 19
ZGJIDHJA E MOSMARRREVESHJEVE

19.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve, apo ndërmjet ortakëve dhe trashëgimtarëve të ortakëve ose ortakëve të tjerë dhe/ ose Shoqërisë që kanë për objekt të drejta të lidhura me Shoqërinë, do të zgjidhen miqësisht ndërmjet palëve të interesuara. Në rast se palët nuk arrijnë një zgjidhje miqësore, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë do të jetë kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Ky Akt Themelimi the Statut hartohet dhe nënshkruhet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKU I VETËM

Marin HOXHAI



Data 08.02.2024